

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj, kryetare, Fillim Skoro, gjyqtar referues dhe Have Haliti, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Sadik Kryeziu, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.B., nga fshati ..., Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Ferizaj dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtëses së të akuzuarit av.V.B., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.173/2016, të dt.25.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.08.01.2019, mori këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Ferizaj dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.173/2016, të dt.25.09.2018, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.173/2016, të dt.25.09.2018, të akuzuarin I.B., nga fshati ..., Komuna e Ferizajit, e liron nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK, në mungesë të provave.

E dëmtuara MEF-i, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore-DKR në Ferizaj, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin I.B., ta shpallë fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë ose të anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen penale ta kthejë në rigjykim dhe vendim.

-Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësja e të akuzuarit, av.V.B., me propozim që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e PTH-DKR në Ferizaj.

Konform nenit 390 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, nuk caktoi seancën e kolegjit, për arsye se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues.

Prokuroria e Apelit DKR në Prishtinë, PPAI.nr.579/18, të datës 26.12.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e PTH-DKR në Ferizaj dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet apo të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim e vendim.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin ankimor detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, me vlerësimin e pretendimeve ankimore të PTH-DKR në Ferizaj dhe përgjigjes në ankesë të mbrojtëses së të akuzuarit, av.V.B. dhe gjeti se:

Ankesa e PTH-DKR në Ferizaj, është e pa bazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore-DKR në Ferizaj, në ankesën e saj pretendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor gjendja faktike në tërësi përputhet me gjendjen faktike të objektit të akuzës. Sipas ankesës edhe pse janë bërë tri ekspertiza, tre ekspertizat kanë treguar se lidhur me çështjen e prokurimit janë konstatuar të njëjtat shkelje siç parasheh ligji i prokurimit publik. Ankesa pretendon se aktgjykimi mbështet në atë se te i akuzuari nuk është manifestuar qëllimi kundërligjshëm i dobisë pasurore për vete ose për tjetrin, dhe nuk është shkaktuar dëm personit tjetër edhe pse i akuzuari kishte vërejtur këto parregullsi. Ky konkludim i gjykatës është i pa qëndrueshëm pasi që i akuzuari ka qenë person me përgjegjësi profesionale ekspert i prokurimit publik dhe i ka ditur detyrat dhe përgjegjësit e tij dhe në këtë çështje penale i akuzuari ka vepruar me qëllim që ti mundësohet operatorit NTP. "NN", që të fitoj kontratën në mënyrë të pa merituar.

Edhe pse aktgjykimi nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit, në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPP, aktgjykimin e vlerësoj edhe sipas kësaj baze ankimore dhe gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota në këtë çështje penale, kur ka marrë aktgjykim lirues për të akuzuarin I.B., në pajtim me dispozitën e nënti 364 par.1 nën par.1.3 të KPP. Gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota se i akuzuari nuk e ka keqpërdorë pozitën apo autoritetin zyrtar dhe nuk i ka mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm NTP."NN", në shumë prej 9.000Euro, si pretendohet në objektin e akuzës, kjo për arsye se eksperti R.B., në ekspertizën e tij sqaron se operatori ekonomik OE " NN", në total për 4 loto ka qenë si ofertues më i lirë, ndërsa sa i përket për loton I, operatori ekonomik OE " NN", nuk ka qenë më i liri , por edhe përkundër kësaj, nuk ekziston shkelje ligjore e tenderit, kjo për arsye se vlerësimi mund të bëhet në total, por edhe veç e veç, dhe shuma prej 9.000 Euro, nuk është përfitim pasuror i kundërligjshëm, dhe nuk kemi dëm material, të njëjtat fakte mbështeten edhe me super ekspertizën e dhënë e në të cilën sqarohet çështja e tenderit për OE " NN", se i akuzuari I.B., nuk ka keqpërdorë pozitën zyrtare, me tejkalimin e kompetencave të tija, dhe nuk ka mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm operatorit OE."NN", prej 9.000Euro, si pretendohet në objektin e akuzës dhe sipas ekspertizës rezultojn se nuk ekziston ndonjë dëm konkret material, ngase nuk ka pasur dëm material, dhe nuk ka pas oferta të tjera të përgjegjshme ma të lira, gjë që super ekspertiza e kryer nga ekspertët përputhet me ekspertizën e kryer nga eksperti R.B., se nuk kemi dobi dhe dëm material, e nga kjo rezultojn se gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare e të cilat janë ngushtë të lidhura me përfitimin e dobisë pasurore për vete apo për tjetrin, e që në këtë çështje penale një fakt i tillë nuk është provuar dhe nga kjo del se aktgjykimi nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave esenciale nga nenit 384 par.1 nën par.1.12 të KPP.

Pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, nuk qëndron dhe gjykata ka nxjerr përfundime të drejta e në bazë të provave të cilat i ka vlerësuar në shqyrtimin gjyqësor dhe në bazë të provave, ekspertizave të kryera nga R.B., dhe ekspertiza e kryer nga A.SH., të cilat

kanë qenë në kundërshtim me njëra tjetrën, këtë e ka sqaruar super ekspertiza, e në bazë të cilës gjykata drejt ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila ekspertizë përputhet me ekspertizën e ekspertit financiar R.B., se i akuzuari në cilësinë e personit zyrtar si udhëheqës i prokurimit ka refuzuar të nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik fitues të tenderit të propozuar nga komisioni për vlerësim dhe i njëjti nuk ka pasur ndikim direkt në parandalimin e realizimit të kontratës së tillë, dhe se me veprimet e tija, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se i akuzuari në asnjë mënyrë nuk i ka shkaktuar dëm material, respektivisht përfitim pasuror të kundërligjshëm OE."NN", e nga kjo rezulton se edhe Ministra për Ekonomi dhe Financa, respektivisht buxheti i Republikës së Kosovës, nuk është dëmtuar në shumë prej 9.000Euro, si pretendohet në objektin e akuzës dhe gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejte dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit, ka vlerësuar ankesën edhe sipas bazës ankimore të shkeljes së ligjit penal, sipas detyrës zyrtare, e në pajtim me dispozitën e nenit 385 par.1 të KPP, edhe pse aktgjykimi në këtë drejtim nuk është ankimuar dhe Gjykaa e Apelit, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar se në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor ka marrë aktgjykim lirues në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, për arsye se nuk është provuar se i akuzuari I.B., të keqpërdorë pozitën apo autoritetin zyrtar me tejkalimi e kompetencave të tija ligjore, si shef i prokurimit publik, ngase i njëjti ka refuzuar të nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik, ndërsa sipas ekspertizave nuk kemi as dëm material-përfitim pasuror të kundërligjshëm për NTP."NN", si operator ekonomik, fitues i tenderit dhe gjykata ka nxjerr përfundim të drejte dhe drejte ka vepruar me marrjen e aktgjykimit lirues ndaj të akuzuarit I.B., e në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP.

Prandaj nga arsyet e përshkruara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, ndërsa ankesa e PTH-DKR në Ferizaj, të refuzohet si e pabazuar, e në pajtim me dispozitën e nenit 400 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.610/2018, me dt.08.01.2019

Procesmbajtësi,

Sadik Kryeziu,

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetare e Kolegjit,

Tonka Berishaj